



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.350/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me numër ZL.Anr.350/2017 e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik AKR dega në Gjakovë, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në afërsi të Qendrës së Votimit 0205C, në oborrin e shkollë fillore “Zekria Rexha” në Gjakovë, ditën e zgjedhjeve me 22.10.2017, është vendosur posterii kandidatit për kryetar të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) Edmond Dushi. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1, pika b), të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesat janë të bazuara

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, Paneli i vlerësoj si të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se nga fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se objekti për të cilin

pretendohet se është shfrytëzuar si Qendër e Votimit në ditën e votimit, ka shërbyer për të votuar sepse nuk është konstatuar nga provat e lartpërmendura asnjë shenjë, të cilin objekt e identifikon si Qendër Votimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 115, 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.350/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyhdi Haziri**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.